# DËSHMI ARKIVI

**A-438235**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE kërkon respektimin e verdiktit të Speciales për ish-krerët e UÇK-së: Vendimi mund të apelohet - Euro news Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/be-kerkon-respektimin-e-verdiktit-te-speciales-per-ish-kreret-e-uck-se-vendimi-mund-te-apelohet/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 11:29:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 11:27:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `982182e997818ed7eb2e4c56623fd4ab3fe8e868ba82c1683395c778dd584c42` |
| TEKSTI | `71bf7173fb0d63365d8dde18fb3ca76d25e1010bbae1f478054f896ac82f1f6b` |
| PAMJA | `20392e56e9936a88f1f518617459e8807fe954417c94425e2230e15e30ab4680` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bca7d971c17f1bf13e141e5b8169a2395af7ef01fbce4dc65bc6e135a6551064` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3ae1d72cb36b0e53b39e3d377718da4bf6c7dbc275c97955f3793e5b48e2ca3f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bca7d971c17f1bf13e141e5b8169a2395af7ef01fbce4dc65bc6e135a6551064`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË

# BE kërkon respektimin e verdiktit të Speciales për ish-krerët e UÇK-së: Vendimi mund të apelohet

12 Shtator 2026 | 13:27

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Bashkimi Europian ka reaguar përpara shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Në një deklaratë për Gazeta Express, BE u ka bërë thirrje të gjitha shteteve dhe palëve të përfshira në proces që të tregohen të përmbajtura dhe të respektojnë procedurat gjyqësore, si dhe vendimin që do të marrë gjykata.

“Në prag të shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë në çështjen e Prokurorit të Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, u bëjmë thirrje të gjitha shteteve dhe palëve që të respektojnë procedurat gjyqësore të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe vendimin”, thuhet në reagimin e Brukselit.

BE ka ritheksuar mbështetjen për Dhomat e Specializuara të Kosovës, duke i cilësuar ato si një institucion gjyqësor të pavarur. Sipas BE-së, institucioni u krijua përmes vendimeve të Kuvendit të Kosovës në vitet 2014-2015, ndërsa procedurat u zhvendosën në Hagë me qëllim garantimin e një procesi të pavarur, të paanshëm dhe të drejtë.

Brukseli ka nënvizuar gjithashtu se vendimi i shkallës së parë nuk shënon përfundimin e procesit gjyqësor.

“Ashtu si në të gjitha procedurat e tjera gjyqësore, ndaj aktgjykimeve të shkallës së parë mund të ushtrohet ankesë si nga mbrojtja, ashtu edhe nga prokuroria”, thekson BE.

Në reagimin e tij, Bashkimi Europian vlerëson se puna e Dhomave të Specializuara është e rëndësishme për garantimin e llogaridhënies dhe për njohjen e përvojave të viktimave dhe familjeve të tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Ndërkohë, në Prishtinë sot zhvillohet një marsh paqësor në mbështetje të katër ish-krerëve të UÇK-së. Pjesëmarrësit kanë kërkuar drejtësi për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin, ndërsa procesi në Hagë është shoqëruar vazhdimisht me kritika nga një pjesë e opinionit publik dhe politik në Kosovë.

Katër ish-drejtuesit e UÇK-së përballen me një aktakuzë prej 10 pikash, ku gjashtë lidhen

LAJMI I FUNDIT

13:15 Në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale, Prishtina bëhet gati për ‘Marshin e Lirisë’, mbështetje për krerët e UÇK

12:56 Dënohet me 12 vite burgim minoreni që vrau me thikë bashkëmoshatarin në Maliq

12:45 Arratisja si në filma e të burgosurit shqiptar në Greqi, gjendet makina me kallashnikov

12:34 Qarkullonte i armatosur me pistoletë, arrestohet 30-vjeçari në Durrës

12:31 Të paktën 2 të vrarë dhe 17 të plagosur nga sulmet në Ukrainë

12:23 Protestë kundër muzeut hebraik në Vlorë. Institucionet: Projekti nuk po ndërtohet në godinën e Klubit Patriotik Labëria

TESTIM

me krime kundër njerëzimit dhe katër me krime lufte. Në fillim të këtij viti, Prokuroria e Specializuar kërkoi dënime me nga 45 vite burg për të akuzuarit.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJM KRYESOR

### Në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale, Prishtina bëhet gati për 'Marshin e Lirisë', mbështetje për krerët e UÇK

Në Prishtinë sot do të mbahet "Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohen në Hagë, vetëm katër...

13:15 | 12/09/2026

KOSOVË

### Qytetarë nga Shqipëria dhe diaspora drejt Prishtinës për marshin në mbështetje të ish-drejtuesve të UÇK-së

Dhjetëra qytetarë nga Shqipëria dhe diaspora janë nisur drejt Prishtinës për t'iu bashkuar marshit kombëtar në mbështetje të ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK),...

12:07 | 12/09/2026

KOSOVË

### Prishtina mban sot Marshin për Liri në mbështetje të ish-krerëve të UÇK në Hagë

Në Prishtinë mbahet sot "Marshi për Liri", i organizuar nga platforma qytetare "Liria ka Emër", në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që...

10:36 | 12/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.